

*Ande G*



## **RELACION TEKNIK**

**MBI PROJEKT ZBATIMIN E OBJEKTIT  
“PUNIME MBROJTJEJE TE KAPTAZHIT NR. 2”,  
BARGJANE, BASHKIA MIRDITE.**

**VENDNDODHJA, NJESIA ADMINISTRATIVE FAN,  
BASHKIA MIRDITE.**

**Shtator 2022**

REPUBLIC OF ALBANIA  
MIRDIË  
BASHKIË

## RELACION TEKNIK



**MBI PROJEKT ZBATIMIN E OBJEKTIT "PUNIME MBROJTJEJE TE KAPTAZHIT  
NR. 2", BARGJANE, BASHKIA MIRDITE.**

**VENDNDODHJA, NJESIA ADMINISTRATIVE FAN, BASHKIA MIRDITE.**

**Kaptazhi Nr. 2, Ujesjellsi Bargjanes.**

Projekti ka paraqitur projektin fillestar te hartuar ne vitin 2006 si dhe punimet qe duhet te realizohen per stabilizimin e bazamentit te godines se Kaptazhit nr. 2, te Ujesjellesit Bargjane, Bashkia Mirdite.






Sheshi "Abat Doe", Retshen

E-mail: [bashka@bashkamtulie.gov.al](mailto:bashka@bashkamtulie.gov.al)

[www.bashkamtulie.gov.al](http://www.bashkamtulie.gov.al)

tel dhe fax (00355) (0) 2162233

A handwritten signature in blue ink, appearing to be "Sheshi".



Sheekh - Abul Doer - Reehen


e-mail [basbhya@basbhyanuridde.gov.sl](mailto:basbhya@basbhyanuridde.gov.sl)

www.basbhyanuridde.gov.sl

tel dhe fax (00355) (0) 2162233

*Abul Doer*





Shechi - Abat Dept - Reshen

e-mail: [bahkhan@beshkhanrdr.de.gov.af](mailto:bahkhan@beshkhanrdr.de.gov.af)  
[www.beshkhanrdr.de.gov.af](http://www.beshkhanrdr.de.gov.af)

tel: the fax: (90355) (0) 2162233

*Shelli oks*

Kaptazhi nr. 2, per shkak te shtimit te sasise se ujit ne kohe dimri dhe te shirave, terreni ku eshte ndertuar ka persuar gerryerje te shumta te cilat kane demtuar bazamentin e tij dhe rrezikojne renien e objektit. Demtimi i kesaj vepre do te linte pa uje banoret e qytetit te Rreshenit dhe te fshatrave perreth.

Punime dherash per themelet (germime, linja drenazhi, etj)

Per mbrojtjen e tij duhet te behet mbrojtja nga rreshqitjet dhe mbushja me cakell te germuar e bazamentit.

Per kete eshte planifikuar qe te vendosen mure me gabion, pasi te jete niveluar terreni me nje shtrese prej 25 cm beton i varfer. Duhet patur kujdes qe te mos levizen guret e medhenj qe kane krijuar nje fare bazamenti pasi mund te jete rreziku i rreshqitjes masive.

Me pas duhet te behet mbushja e bazamentit me cakell te germuar. Dhe pista para godines eshte parashikuar te kete nje shtrese betoni.

Zona perreth objektit eshte parashikuar te behet kunete betoni per sistemimin e ujrave siperfaqesore dhe largimin e tyre pa rrezikuar bazamentin e ri. Meqenese po krijohet mundesi per nderhyrje eshte planifikuar nje nderhyrje ne skemen e furnizimit me uje, duke ndare tubin e teperplotesit nga shkarkuesi fundor dhe duke ngritur nivelin e teperplotesit ne nivelin e percaktuar ne projektin fillestar.

Punimet e dherave per bazamentin dhe instalimin e tubave & aksesoreve te tyre, mbushjeve dhe drenimi perreth depos. Linjat e tubave do te jene celik dhe do te lidhen me ane te adaptoreve me fillanxa. Te gjitha nderhyrjet e nevojshme do te instalohen sipas skemave te percaktuara. Te gjitha materialet e tubave dhe valvolave do te sigurohen sipas standarteve ISO.

Nderhyrja do te permbushe te gjitha kerkesat dhe obligimet e te gjitha klauzolave te specifikimeve te zbatueshme ne punimet e ndertimit. Sistemi hidraulik i depos do te perfshije: Tubat e hyrjes dhe pjeset e tyre lidhese, Tubat e daljes dhe pjeset e tyre lidhese Tubat e shkarkimit, Tubat e teperplotesit.

Kushtet e dherave ne terren jane shume te mira.

Grupi i projektimit me marrjen e detyres beri rikonicionin ne vend me perfaqesues te Bashkise Mirdite. U bene matjet topografike te nevojshme te Vepres se Marrjes egzistuese, te vendit ku mendohet te nderhyhet dhe te akseve ku do te kalojne linjat si ajo e dergimit ashtu dhe ato te shkarkimit fundor.

ORGANIZIMI I PUNIMEVE. Per ndertimin e objektit Bashkia Mirdite projekti parashikon te perdoren materiale te cilësisë së lartë sipas standarteve të vendit dhe ndërkombëtare dhe të zbatohen me rigorozitet Kushtet Teknike të Zbatimit të punimeve. Gërmimet për marrjen e materialeve duke patur parasysh terrenin dhe problemet sociale qe mund te lindin gjate punimeve, janë parashikuar të kryhen me makineri dhe me krah.

Vlera e punimeve te objektit "Punime mbrotjeje te Kaptazhit Nr. 2" me 5 % fond rezerve dhe 20% TVSH duke u mbeshtetur tek Manuali i miratuar me VKM Nr.629, date 15.07.2015 dhe hartimi i analizave per zerat qe nuk jane ne kete manual eshte **3 230 853 lek** me t.v.sh

Pergatiti: Ing. A. DUKAJ

